

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11), si dhe në bazë të nenit 50 alinea 6 të Ligjit për arsim fillor („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.161/2019) ministri i Arsimit dhe Shkencës e solli programin e shkurtuar nga lënda e gjuhës gjermane (gjuha e dytë e huaj) **për klasën VI (e gjashtë)** të arsimit fillor nëntëvjeçar për vitin shkollor 2020/21

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS**

**BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**



**PROGRAM I SHKURTUAR MËSIMOR**

**GJUHË GJERMANE  
GJUHË E DYTË E HUAJ**

**KLASA VI (e gjashtë)**

**ARSIMIT FILLOR NENTËVJEÇAR**

**Shkup, 2020**

### Hyrje:

Programi i shkurtuar mësimor për lëndën **gjuhë gjermane (gjuhë e dytë e huaj)** bazohet në rezultatet e të nxenit të parashikuara në programin mësimor për lëndën që realizohet rregullisht në përputhje me planprogramin e përcaktuar mësimor.

Programi i shkurtuar përcakton tema të caktuara dhe njësi mësimore që duhet të realizohen për 159 ditë me kohëzgjatje të orës prej 35 minutash, ndërsa respektohet fondi i planifikuar favor i orëve i përcaktuar me programin e rregullt, 2 orë në javë, pra gjithsej 64 orë.

Mësimdhënësi gjatë planifikimit dhe realizimit të njësive mësimore nga programi i shkurtuar udhëhiqet nga qëllimet/rezultatet e të nxenit, përmrbajtjet dhe nacionet, aktivitetet dhe metodat të caktuara në programin e rregullt mësimor.

## 1. Pasqyra e temave<sup>1</sup>

Tema: Kontaktet e para (21 orë )

Tema: Rrethimi (21 orë )

Tema: Koha e lirë (22 orë )

## 2. Rekomandimet didaktike

Qëllimi i këtyre rekomandimeve didaktike nga programi i shkurtuar mësimor që do të jetë udhëzues për elementet më të rëndësishme që duhet të përfshihen është të ndihmojë mësimdhënësit për të arritur rezultatet e përcaktuara të të nxënët nga programi i rregullt mësimor për kl.VI (e gjashtë) të shkollës fillore. Baza për realizimin e programit të shkurtuar mësimor për lëndën gjuhë gjermane (gjuhë e dytë e huaj) është programi i rregullt mësimor (rezultatet e të nxënët, përmbajtjet dhe konceptet, aktivitetet dhe metodat si dhe standartet e vlerësimit).

Në programin e shkurtuar për kl.VI janë marrë parasysh përmbajtjet në programin mësimor sipas lëndëve tjera që mësohen në këtë klasë, apo respektohet parimi i ndërlidhjes ndërmjet lëndëve në bazë të qëllimeve dhe përmbajteve, me theks të ndërlidhjes integrale me përmbajtjet nga gjuha amtare.

---

<sup>1</sup> Në lidhje me temat e dhëna dhe fondi i orëve me program të shkurtuar mësimor, mësimdhënësi bën vlerësim të mënyrës dhe thellësisë së përpunimit të se cilës temë individualisht, duke marr parasysh qasjen e balancuar dhe integruar në mësimin e gjithë elementeve gjuhësore

Në fokusin e kujdesit të mësimit bashkohor është nxënësi dhe procesi i të mësuarit. Duhet të respektohen mosha, nevojat dhe interesi i nxënësve. Mësimdhënësi nuk është më burim i vetëm i njohurive, informatave dhe roli i tij nuk është vetëm bartës i njohurive. Rol i tij është t`i nxisë nxënësit që të shfrytëzojnë edhe burime të tjera të njohurive dhe informatave dhe t`i mësojë se si të mësojnë.

Gjatë zgjedhjes të aktiviteteve duhet të ken kujdes për diferençimin dhe llojaljoshmërinë. Duhet të zgjidhen ose të adaptohen aktivitete të cilët do t`i perqigjen llojeve të ndryshme të stileve të mësuarit (vizuele, auditive, kinestetike,) në llojet e ndryshme të intellegrancës (verbale-gjuhesore, matematiko-logjike, muzike-ritmike, vizuele-hapësinore, etj,) si dhe niveli i njohurive të nxënësve.

Duhet pasur parasysh se motivimi për të mësuar përmirësoshet nga format e ndryshme të punës në mësimdhënie (frontale, individuale dhe puna në çifte dhe grupe), si dhe ndryshimi i veprimtarive më të shkurtra dhe më të gjata, rebele dhe më të qeta, periudha të vëmendjes së përqëndruar dhe relaksimi i nxënësve gjatë orës së mësimit. Mësimi i gjuhës gjermane bazohet në të mësuarit holistik që përfshin aspektet kognitive, afektive dhe motorike të nxënësve, gjegjësisht mësimdhënesi do të integroj komponentët e ndryshëm në mënyrë që gjuha të mësohet në mënyrë funksionale. Sipas kësaj që thamë më lartë, në mësimin e gjuhëve të huaja nuk mund të ndahan, gjegjësisht nuk mund të planifikohet numri i orëve sipas komponentëve /aftësive individuale.

Gradualisht futet metagjuha në moshën përkatëse dhe nivelin e njohjes së gjuhës. Në këtë periudhë tentohet që të zhvillohet komunikimi gojor dhe me shkrim.

Nxënësi nxitet ta zbulojë fuksionimin e gjuhës gjermane nëpërmjet shembujve e cila analizë do t`i ndihmojë të nxjerrë përfundime adekuate, si dhe nëpërmjet krahasimit me gjuhën amtare dhe me gjuhë tjera që i mëson.

Përvec kësaje, në mënyrë të njëjtë i kushtohet kujdes të gjitha shprehive gjuhësore, *dejtim* dhe *lexim* me kuptim, *bisedim*, si nga aspekti i bisedës interaktive, ashtu edhe nga aspekti produktiv, si dhe aftësia e te *shkruarit*.

Mësimdhënësi duhet ta nxisë dhe zhvillojë autonominë e nxënësve nëpërmjet aktiviteteve dhe detyrave që i aftësojnë ta marrin përgjegjësinë për mësimin dhe njohuritë e veta që e fitojnë në kontekst formal të mësuarit (në klasë) dhe ta shfrytëzojnë jashtë saj. Nga kjo del se në orët e gjuhës gjermane fitohen kompeteca gjuhësore dhe socio pragmatike dhe njohuri të cilat janë të nderlidhura me vetë procesin mësimor.

Nga e theksuara më lart del se mësimdhënësi duhet t`i mësojë nxënësit që si më lehtë dhe më shpejtë të mësojnë, si ta ruajnë të mësuarën dhe si ta shfrytëzojnë diturinë në situata të reja jashtë mësonjëtores .

Mësimdhënësi duhet t`i njoftojë nxënësit me qëllimet dhe përbajtjet e aktiviteteve (detyrat) materialet dhe strategjitë e të mësuarit të cilat ato i praktikojnë në nivelet më të larta të të mësuarit.

Nga mësimdhënësi pritet që t`i mësojnë nxënësit të zhvillojnë dhe praktikojnë strategji për mësim të suksesshëm.

Mësimi realizohet në pjesën më të madhe në gjuhën gjermane, ndërsa gjuha amtare përdoret atje ku është e domosdoshme - Për kontrollimin e të kuptuarit të fjalëve -fjali, për lehtësimin e bartjes së njohurive, kur është ajo e domosdoshme për të dhënë udhëzime për aktivitetet e nivlet filletar të të mësuarit e gjuhës, gjatë njohjes me vetitë sociokulturore të kulturave të tjera dhe për të bërë krahasim ndërmjet gjuhës amtare dhe gjermane.

Në kornizë të fondit të orëve të paraparë me këtë program të shkurtuar mësimor rekandohet mesimi i detyrueshem i të gjithë komponenteve gjuhësore (strukturat gramatikore, njësi leksikore dhe funckione gjuhësore) në kornizë të çdo teme.

Edhe përskaj saj që para mësimit të gjuhëve të huaja, ekziston integrim i komponentave gjuhësore dhe shkathesive gjuhësore (dejim dhe lexim me kuptim, të shprehurit gojor dhe të shkruarit), rekandohet që mësimdhënësi të vendosë theks dhe në shkathesitë gjuhësore apo shkathësi e caktuara gjuhësore për të cilën do të vendosë se është e rëndësishme për përvetësimin e përbajtjeve dhe termeve, në vecanti ta përpunojë. Përbajtjet interkulturore parapëlqehet të përvetësohen nëpërmjet përbajtjeve të ngjashme. Orët e parapara me programin e rregullt mësimor për përforcimin e përbajtjeve mësimore (të mësuara) të janë të reduktuara ndërsa aktivitetet të janë të integruara në orët e parapara për përbajtjet e reja mësimore. Në aspektin e metodave dhe aktiviteteve propozohet reduktimi i tyre apo zgjedhje e metodave apo aktiviteteve më efektive për përvetësimin e njesisë së dhënë dhe akomodimi i kohezgjatjes së orës mësimore për 30 minuta. Në veçanti është e rëndësishme që gjat të mësuarit të gjuhës së dytë të huaj me të cilën përballen nxënësit për herë të parë në kl VI, mësimdhënësi t`i kushtojë vëmendje fonetikës (të folurit dhe theksi) dhe e njëjta të përpunohet në mënyrë të sinhronizuar me komponentet dhe shkathësi tjera, dhe jo veçmas si në programin e rregullt mësimor.

Duhet të theksohet se në këtë program të shkurtuar mësimor nga gjuha gjermane, numri i dhënë i orëve në tema të caktuara mundet të ndërrohet, apo i jepet liri mësimdhënësit për mënyrën e organizimit të mësimit dhe orëve, nëpërmjet të lidhurit me të mësuarën më parë, si dhe fuzimi i njësive mësimore .

#### **4. Normativi i kuadrit mësimor**

Programin e shkurtuar mësimor e realizon arsimtari në pelqim të normativit për kuadrin mësimor i dhënë në programin e rregullt mësimor.

Programin e shkurtuar mësimor nga lënda mësimore **gjuhë gjermane**(gjuhë e dytë e huaj) për klasën VI (e gjashtë) në mësimin fillor nëntëvjeçar e verifikoi

Ministri i Arsimit dhe Shkencës

Milla Carovska

---